



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.1261, datë 28.04. 2010

Për

**“Fillimin e procedimit administrativ per zgjidhje mosmarrveshje
interkoneksioni midis Alban Tirana Nascendo Al sh.p.k dhe Albtelecom sh.a”**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
3. Z. Benon	Paloka	Anëtar
4. Z. Ibsen	Elezi	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj.Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 28.04.2010, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Zgjidhje mosmarreveshje Interkoneksioni midis Alban Tirana Nascendo sh.p.k dhe Albtelecom sh.a ”.

BAZA LIGJORE

1. Neni 120, i Ligjit nr.9918, datë19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”
2. Nenet 66-104 te ligjit nr. 8485, date 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (KPrA).
3. Rregullore Per Aksesin dhe Interkoneksionin miratuar me VKD nr.416,date 07.12.2007.
4. Marreveshje Aksesi/Interkoneksioni per ofrimin e sherbimit te thirrjes me karte te parapaguar ndermjet Albtelecom sh.a dhe Alban Tirana Nascendo Al. Sh.p.k protokolluar me nr.2041,date 7.05.2009.

5. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendshme të AKEP (Rregullorja e Brendshme), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, Nr. 170, datë 24.04.2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, si dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar :

V Ë R E N :

1. Sipermarresi Alban Tirana Nascendo Al sh.p.k me shkresen nr.4 prot,date 25.02.2010 drejtuar AKEP dhe per dijeni Albtelecom sh.a sqaron se:
 - Alban Tirana Nascendo Al sh.p.k eshte mbajtesi i autorizimit te konfirmuar nga AKEP, nr.2855/1prot, date 28.10.2008 dhe ofron sherbimin me karte te parapaguar.
 - Alban Tirana Nascendo Al ka lidhur marreveshje Aksesi/Interkoneksioni me Albtelecom sh.a nr. 3223, date 29.04.2009, per te lejuar rrugezimin e thirrjeve drejt rrjeteve celulare, ku Albtelecom sh.a nuk e ka zbatuar.
2. AKEP, me shkrese nr.765/1 prot, date 08.03.2010, “ Mbi ankesen e sipermarresit Alban Tirana Nascendo Al., derguar Albtelecom dhe per dijeni Alban Tirana Nascendo Al, i ka kerkuar Albtelecom sqarime me shkrim ne lidhje me pretendimet e paraqitura nga sipermarresi “Alban Tirana Nascendo Al” sh.p.k brenda dates 20.03.2010.
3. Albtelecom, ne vijim te shkreses se AKEP, me shkrese nr. 765/1 prot, date 08.03.2010, drejtuar AKEP, dhe per dijeni sipermarresit Alban Tirana Nascendo Al, mes te tjerave ve ne dijeni se:
 - Albtelecom i ka bere te qarte te gjitha OSHKP_THK-ve veshtiresite teknike qe do te kishte dhe qe aktualisht ka per te gjitha palet: OSHKP_THK – Albtelecom (tranzitues) – Operoret Mobile (terminues), implementimi i ketij sherbimi. Zgjidhja teknike nuk qendron vetem tek Albtelecom, por dhe ne bashkepunimin me OSHKP_THK dhe operoret Mobile.
 - Albtelecom sqaron se sipermarresi Alban Tirana Nascendo Al duhet te kete te qarte se natyra e sherbimit te thirrjes me karte eshte specifike sidomos me rastin e tranzitimit ku pikerisht nje nga problemet kryesore eshte se me c’fare CLI do te vijoje thirrja drejt Operatorve Mobile apo te tjere.

Nderkohe qe ne rastin e OSHKP_THK-ve thirrjet origjinohen po nga rrjeti Albtelecom (abonentet qe perdorin karten e parapaguar). Ceshtja shtrohet se si do te behet evidentimi i trafikut drejt dhe me operoret e tjere terminues.

-Albtelecom nuk mund tu pergjigjet interesave individuale pa u siguruar qe kjo nuk do te efekteje teknikisht te gjitha lidhjet e tjera te aksesit dhe interkoneksionit ne lidhje me evidentimin e trafikut te shkembyer, si dhe sqaron se Alban Tirana Nascendo Al. eshte i lire te zgjedhe rruge alternative per t'i ofruar kete sherbim perdoruesve te tij te kartes, sic aktualisht ben nepermjet teknologjise VoIP.

-Albtelecom tregohet i gatshem qe me harmonizimin e mundesive teknike per te gjitha palet qe lidhen me tranzitimin OSHKP_ THK-Albtelecom-Mobile, te mundesoje rrugesimin e thirrjeve drejt operatoreve mobile, si dhe te bashkepunoje duke u ulur ne nje tavoline shumepaleshe me Alban Tirana Nascendo Al, operatoret mobile dhe AKEP.

4. Alban Tirana Nascendo Al. me shkresen nr. 7/1 prot, date 29.03.2010 drejtuar AKEP dhe per dijeni Albtelecom sh.a , nder te tjera ben te ditur se:

-Argumentet e Albtelecom sh.a dhene me shkresen nr. 1056/2 prot, dt. 25.03.2010, jane te pa bazuara teknikisht dhe ligjerisht.

Alban Tirana Nascendo Al. sqaron se trafiku i gjeneruar nga perdoruesit e kartes Alban Tirana Nascendo Al eshte nje trafik i cili percjell CLI e perdoruesit te kartes, dhe si rrjedhoje nuk ka nevojte per shume argumentim me apo pa CLI,do te vendosen apo jo numrat e aksesit 0801xxx te kompanise. Gjithashtu, Alban Tirana Nascendo Al thekson se trafiku qe terminojne dhe tranzitojne ne rrjetin e Albtelecom eshte i teri me CLI dhe ne asnje rast nuk ka dale problem “me apo jo” CLI, apo “ me apo jo” numer aksesi.

-Alban Tirana Nascendo Al. ne argumentat e vet per zgjidhjen teknike i referohet mundesimit nga Albtelecom per trafikun e gjeneruar prej kartes se vet “Alb Blue”, e cila percjelle vetem CLI e perdoruesit te kartes.

-Alban Tirana Nascendo Al. sqaron se nga pikpamja ligjore Albtelecom, AMC, Vodafone jane OFNT dhe ne rastin e interkoneksionit dy palesh (Alban Tirana Nascendo Al me Albtelecom) per trafikun e terminuar drejt operatoreve mobile, keta te fundit jane perfitues te ketij sherbimi dhe ne asnje raste nuk duhet marre mendim per rrugesimin apo jo te ketij trafikun nga operatoret mobile.

5. Sipermarresi Alban Tirana Nascendo Al sh.p.k me shkrese nr.8 prot, date 29.03.2010 drejtuar AKEP mes te tjerave ben te ditur dhe kerkon si me poshte:

-Nderhyrjen administrative dhe ligjore nga AKEP per zgjidhjen e mosmarreveshjes dhe zbatimin korrekt te Marreveshjes se Interkoneksionit me Albtelecom sh.a.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e zgjidhjes se mosmarreveshjes se interkoneksionit per te dy sipërmarrësit, perdoruesit e rrjeteve te tyre dhe rregullimin e marredhenieve ne treg, bazuar në pikën 1 të nenin 114, dhe pikën 1 të nenit 115 të ligjit nr. 9918, si dhe pika 17, neni 21 të Rregullores së Brendëshme te AKEP, e ndryshuar,

V E N D O S I:

1. Të filloje procedimin administrativ per zgjidhjen e mosmarreveshjes se interkoneksionit midis sipermarresve “ Alban Tirana Nascendo Al “ sh.p.k dhe Albtelecom sh.a.
2. Palet deri me date 15.05.2010, te depozitojne ne AKEP pretendimet me shkrim.
3. Zhvillimin e nje seance degjimore me date 25.05.2010, ora 10.00, ne ambientet e AKEP.
4. Për ndjekjen e ketij procedimi administrativ, ngarkohet Drejtoria e Rregullimit Ekonomik dhe Drejtoria Juridike.
5. Të njoftohen palët e interesuara per kete vendim.
6. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit www.akep.gov.al

Ky Vendim hyn në fuqi ne datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANËTARET E KËSHILLIT DREJTUES:

1. **Alketa MUKAVELATI**
2. **Benon PALOKA**
3. **Ibsen ELEZI**
4. **Zamira NURCE**